www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 2

**Tiranë – E enjte, 22 janar 2015**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr. 2, datë 19.1.2015 | Për ngritjen dhe funksionimin e sekretariateve teknike, për Administrimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve..... | 9 |
| Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr. 4, datë 19.1.2015 | Për shpalljen e thirrjes së parë për projekte, për të gjitha programet e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015..... | 17 |
| Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 374, datë 16.1.2015 | Për delegim kompetence..... | 25 |

**VENDIM**
**Nr. 2, datë 19.1.2015**

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SEKRETARIATEVE TEKNIKE, PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Sekretariatet teknike në ministritë përkatëse të linjës, ngrihen me akt të posaçëm të ministrit përkatës, sipas programeve të financimit nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, specifikuar si më poshtë vijon:

a) Shtylla 1: Programet e zhvillimit vendor dhe rajonal

- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Sekretariati teknik për grantet konkurruese për arsimin, pranë Ministrisë së Arsimit;
- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për shëndetësinë, pranë Ministrisë së Shëndetësisë;
- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për artin dhe kulturën, pranë Ministrisë së Kulturës;
- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për ujësjellës-kanalizimet, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës;
- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për vaditjen dhe kullimin, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin, pranë Ministrisë së Mjedisit

b) Shtylla 2: Programi "Shqipëria digjitale" (inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit):

-Sekretariati teknik për grantin konkurrues për programin "Shqipëria digjitale", pranë Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2. Përbërja e sekretariateve teknike duhet të sigurojë/garantojë vendimmarrje politike, planifikim dhe programim nevojash për financim, sipas specifikës së programit, vlerësim teknik dhe financiar të projekteve, si dhe asistencë në mirëmbajtjen dhe përditësimin e bazës elektronike të informacionit.

3. Sekretariatet teknike ngarkohen:

- të administrojnë aplikimet, të kryejnë procesin e vlerësimit tekniko-financiar, ligjor, të përputhshmërisë me programet dhe nënprogramet zhvillimore, impaktin e aplikimeve për financim dhe raportimin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, përpara datës së mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

-të bëjnë njoftimin zyrtar të subjekteve fituese, monitorimin e statusit dhe ecurisë së zbatimit të projekteve dhe raportimin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, çdo 1 (një) muaj, duke filluar nga data e publikimit në "Fletoren zyrtare", të vendimit për financim nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

- të bëjnë vlerësimin e riskut financiar dhe të zbatimit, realizimit të investimeve dhe impaktit të projekteve të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe raportimin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në mënyrë periodike, duke filluar nga data e publikimit në "Fletoren zyrtare", të vendimit për financim nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

- të bëjnë raportimin vjetor mbi performancën e financimit e të zbatimit të programeve dhe nënprogrameve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, jo më vonë se java e dytë e muajit dhjetor të vitit kontraktual, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

- të bëjnë analizën vjetore, të programojnë politikën dhe drejtimet prioritare të vitit të ardhshëm, dhe të dërgojnë propozimet për programet e nënprogramet e zhvillimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm.

4. Rregullat e organizimit të punës hartohen të detajuara dhe miratohen nga ministri përgjegjës për

menaxhimin e programeve dhe nënprogrameve, respektive.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Arsimit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Mjedisit, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Anëtar; |
| Ministri i Financave | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit | Anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | Anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar; |
| Ministri i Kulturës | Anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | Anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar. |

**Aneksi 1.** Raporti i vlerësimit tekniko-financiar për aplikimet për financim (model reference)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e _____

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE**
FZHR 2015
SEKRETARIATI TEKNIK

1. **Përshkrim i përgjithshëm**

Në bazë të vendimit nr. ___ datë ___, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave "Për _____", Ministria e_____, në rolin e sekretariatit teknik, pranoi aplikimet për financim të ____ projekteve nga njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë e zhvillimit, nga data ____ deri në datën _____. Projektet konsistonin konkretisht në fushat:

- -------
- -------
- --------

Për të gjitha projektet aplikuese është kryer vlerësimi në bazë të kritereve të përcaktuara në vendimin(et) të sipërcituar(a) si dhe nënkriteret e përcaktuara nga sekretariati teknik, dhe për projektet e vlerësuara në përputhje me këto kërkesa është kryer vleresimi teknik. Procesi i verifikimit dhe vlerësimit teknik të projekteve eshte kryer nga Sekretariati Qendror Teknik i Ministrisë së ____ i ngritur me urdhrin nr ----- datë ----- nga ministri i ----------, Z.-------- ----------. Vlerësimi u krye, i asistuar nga stafi i Ministrisë në rolin e sekretariatit teknik.

2. **Procesi i vlerësimit**

Të gjitha projektet janë vlerësuar sipas kritereve ligjore dhe teknike të përcaktuara në vendimin e KZHR-së dhe nënkriteret e Sekretariati Qendror të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

Kriteret e vlerësimit teknik janë, si më poshtë:

- Cilësia teknike dhe kostimi (detaje teknike dhe preventiv i kostuar saktë sipas buletinit), nga 0-25 pikë;
- Nivel i ulët i riskut (zbatim me sukses i projektit dhe përdorim në kohë i fondeve publike), 0-10 pikë;
- Ndikimi i projektit (në më shumë se një njësi vendore, 0-5 pikë dhe në shërbimet bazë në cilësinë e jetës, nga 0-5 pikë);
- Bashkëfinancim nga njësitë vendore ose donatorët, nga 0-5 pikë;
- Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga realizimi i projektit, nga 0-10 pikë;

- Analizat dhe studimet e kryera (studim i ndikimit në mjedis, studim fizibiliteti etj.), nga 0-5 pikë.
- Qëndrueshmeria e investimit (kosto mirëmbajtje për vazhdimësinë etj), nga 0-5 pikë.

*(mënyra e vendosjes së pikëve për secilin nga kriteret e mësipërme pasyrohet në tabelën shoqëruese për secilin nga projektet që janë vlerësuar gati për zbatim.*

**3. Përgatitja e vlerësimit teknik për secilin projekt**

Raporti i vlerësimit përfshin të gjitha të dhënat e marra gjatë procesit të vlerësimit. Në raport përcaktohen qartë të dhënat teknike të projektit, kategorizime të cilësisë së dokumentacionit, statusi i zbatueshmërisë së projektit, si dhe ndikimi në mjedis dhe studimi i fizibilitetit (opsionale).

Projektet janë kategorizuar në ---- grupe, si më poshtë vijojnë:

- Projekte gati për zbatim, të strukturuara sipas qarqeve, njësive vedore dhe vlerave respektive;
- Projekte që kanë nevojë për përmirësime, të strukturuara sipas qarqeve, njësive vendore dhe vlerave respektive; dhe
- Projekte që nuk janë gati për zbatim *(për të cilat është gjykuar të njoftohen për plotësimin dhe saktësimin e dokumentacionit për të vijuar me trajtimin në fazën pasardhëse)*

Bazuar në problematikën e ndeshur, janë hartuar komentet për secilin projekt në formatin e vlerësimit.

**4. Gjetje kryesore e rekomandime**

Pas verifikimit të projekteve që kanë aplikuar pranë sekretariatit teknik u konstatua një numër i madh aplikimesh që plotësonin kriteret teknike dhe u klasifikuan si projekte gati për zbatim, përkatësisht:

1. -------
2. --------
3. ------
4. -------
5. -------

Referuar kategorizimit të mësipërm, nga ----- projekte të shqyrtuara, rezulton, si më poshtë vijon:

| STATUSI I PROJEKTEVE | NUMRI I PROJEKTEVE |
|---|---|
| Projekte gati për zbatim | ----- |
| Projekte të cilat janë gati për zbatim, por kanë nevojë për përmirësime | ----- |
| Projekte të cilat nuk janë gati për zbatim | ----- |

Në përfundim të vlerësimit, konstatohet se janë ------ projekte gati për zbatim, të vlerësuara sipas kritereve të vlerësimit teknik e financar.

Raporti i plotë i sekretariatit teknik, për efekt dokumentimi të procesit, duhet të ketë bashkëlidhur:

- **Lidhja 1**

Tabela e projekteve që janë gati për zbatim, të strukturuara sipas qarqeve, njësive vendore dhe vlerave respektive.

- **Lidhja 2**

Tabelat e vlerësimit me pikë, sipas kritereve teknike, për të gjitha projektet të kategorizuara si gati për zbatim.

- **Lidhja 3**

Pasaportat specifike për sicilin projekt fitues.

- **Lidhja 4**

Lista e plotë e aplikimeve që kanë depozituar njësitë aplikuese, pranë Ministrisë së --------.

**Aneksi 2.** Raporti mbi statusin e projekteve fituese dhe ecurinë e zbatimit të punimeve (model reference)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e _____

**RAPORT MBI STATUSIN E PROJEKTEVE FITUESE DHE ECURINË E ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

FZHR 2015

SEKRETARIATI TEKNIK

**I. Statusi i projekteve fituese në varësi të aplikimit të procedurave të prokurimit**

- Jepni statusin e projekteve fituese, duke paraqitur numrin e projekteve që:

  a) nuk kanë nisur procedurat e prokurimit,

  b) kanë shpallur tenderin,

  c) janë duke vlerësuar ofertat,

  ç) kanë shpallur fituesin,

  d) kanë lidhur kontrata, dhe,

  dh) kanë nisur punimet.

- Paraqitni problematikën e ndeshur gjatë aplikimit të procedurave të prokurimit dhe jepni numrin e projekteve që kanë vonesa në aplikimin e procedurave të prokurimit.

- Verifikoni dhe raportoni nëse ka projekte të cilat nuk kanë respektuar ose janë të vonuar në aplikimin e procedurave të prokurimit, duke rrezikuar djegien e fondit të akorduar e, si rrjedhojë, mund/duhet t'u anulohet financimi i projektit.

- Sa janë tepricat e fondeve të akorduara, pas lidhjes së kontratave të punimeve, dhe bëni propozime për rialokimin e fondeve të tepruara, sipas nevojave të programit.

**II. Ecuria e zbatimit të punimeve, të projekteve fituese**

- Si ka qenë ecuria e projekteve që nga momenti i çeljes së fondeve? Jepni statusin e projektit në %, përshkruani fazën në të cilën ndodhet.

- Cilat janë aktivitetet që pasojnë deri në përmbylljen e projektit. Jepni afatin e parashikuar për përmbylljen e projektit.

- Sa projekte janë përmbylluar dhe sa janë në vazhdim? Jepni edhe vlerën e fondit të nevojshëm për përmbylljen e projekteve në vazhdim, sipas fushave respektive të financimit.

- Verifikoni dhe raportoni nëse ka projekte, të cilat:

  a) kanë performancë të dobët të zbatimit të punimeve, dhe për të cilat duhet reduktuar fondi i akorduar për vitin kontraktual;

  b) kanë performancë shumë të mirë të zbatimit të punimeve dhe duhet avancuar me fondin e akorduar për vitin kontraktual.

**III. Vlerësimi i riskut financiar për projektet me ecuri punimesh nga 0-10%**

- Vlerësimi i riskut të realizimit të investimit, të planifikuar për vitin 2015, të bëhet në bazë të 4 (katër) kritereve të vlerësimit, si më poshtë vijon:

  c) Statusi aktual i projektit (nuk ka nisur procedura, në tenderim, lidhur kontratën);

  d) Zbatueshmëria/mundësia kohore e projektit;

  a) Mundësia zbatuese/menaxhuese e autoritetit kontraktues (niveli i NJQV që menaxhon fondin);

  b) Vlera e planifikuar për investim në vitin 2015.

- Jepni numrin e projekteve sipas klasifikimeve "Risk i lartë", "Risk mesatar" dhe "Risk i ulët".

**IV. Rekomandime dhe sugjerime**

- Propozoni zgjidhje dhe jepni rekomandime për administrimin riskut dhe të projekteve, sipas klasifikimeve të riskut.

**Aneksi 3.** Raporti vjetor mbi performancën e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (model reference)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e _____

**RAPORT VJETOR MBI PERFORMANCËN E FZHR**

FZHR 2015

SEKRETARIATI TEKNIK

Ky raport vlerësues përmbledh ecurinë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Do të përmbajë të dhëna shifrore, tabelare etj., mbi numrin e projekteve të aplikuara, të shpallura fituese për financim, informacion mbi projektet në vazhdim të trajtuara me skemën e borxhit. Probleme të identifikuara dhe rekomandime për adresimin e tyre:

**I. Ecuria e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014**

- Sa është fondi i alokuar për vitin 2014, i ndarë sipas fushave të investimit. Informacioni të shoqërohet me të dhëna shifrore dhe tabelare.
- Jepni numrin e NJQV-ve që kanë aplikuar, numrin e projekteve të aplikuara dhe numrin e projekteve të shpallura fituese. Informacioni mbi projektet e financuara duhet të paraqesë dhe orientimin e financimit sipas rajoneve të Shqipërisë.
- Si ka qenë ecuria e projekteve që nga momenti i çeljes së fondeve? Jepni statusin e projektit në %, përshkruani fazën në të cilën ndodhet dhe cilat janë aktivitetet që pasojnë deri në përmbylljen e projektit. Jepni afatin e parashikuar për përmbylljen e projektit.
- Sa projekte janë përmbylluar dhe sa janë në vazhdim? Jepni edhe vlerën e fondit të nevojshëm për përmbylljen e projekteve në vazhdim, sipas fushave respektive të financimit (infrastrukturë vendore, ujësjellës-kanalizime, vaditje-kullim, arsim, pyllëzim, shëndetësi, art-kulturë).
- Vlerësoni se cilat nga NJQV-të rrezikon menaxhimin apo përmbylljen e projektit/investimit, si pasojë e reformës territoriale, ndryshimit të kufijve administrativë.
- Paraqitni problematikën e identifikuar gjatë procesit të FZHR-së në tërësi (shpallja e thirrjes, shpërndarja e fondit, çelja në thesar, prokurimi e tenderimi, komunikimi me NJQV-të etj.). Propozoni zgjidhje dhe jepni rekomandime për adresimin e problematikës së ndeshur.

**II. Planifikimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve 2016**

- Jepni parashikimet / projeksionin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për periudhën 2016, sipas parashikimeve buxhetore 2016.
- Sa i përmbush ky fond i parashikuar për periudhën 2016 nevojat e ministrisë për mbylljen e projekteve në vazhdim dhe hapjen e projekteve të reja.

**III. Rekomandime dhe sugjerime**

- Propozoni zgjidhje dhe jepni rekomandime për administrimin dhe koordinimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

**VENDIM**
**Nr. 4, datë 19.1.2015**

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË PARË PËR PROJEKTE, PËR TË GJITHA PROGRAMET E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së parë për projekte për financim, për vitin 2015, nga Fondi për Zhvillimin e rajoneve, sipas drejtimeve prioritare dhe programet e aplikimit, si më poshtë vijon:

a) Programi 1: Infrastruktura vendore dhe Rajonale

b) Programi 2: Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim

c) Programi 3: Arsimi dhe Sporti (bazë, i mesëm, universitar)

ç) Programi 4: Ujësjellës-Kanalizimet

d) Programi 5: Artin dhe Kulturën

e) Programi 6: Shqipëria Digjitale (inovacion dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit)

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Arsimit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Mjedisit, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Anëtar; |
| Ministri i Financave | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | Anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit | Anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | Anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar; |
| Ministri i Kulturës | Anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | Anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | Anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar. |

## Shtojca I

## KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

| Afati | Institucioni përgjegjës | Aktiviteti |
|---|---|---|
| Botimi në fletoren zyrtare | Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve | Hapja e thirrjes për projekt-aplikime për projekte në programet sipas pikës 5, të këtij vendimi. |
| **27.01.2015**<br><br>**Për projektet e programit Shqipëria Dixhitale, do të ketë edhe një afat të dytë: 27 shkurt 2015.** | Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër. | Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon:<br><br>1.Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon:<br>a) Programi 1: Infrastruktura Vendore dhe Rajonale– Ministria e Zhvillimit Urban<br>b) Programi 2. Rehabilitim Mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim– Ministria e Mjedisit<br>c) Programi 3. Arsimi dhe Sporti – Ministria e Arsimit<br>ç) Programi 4. Ujësjellës - Kanalizimet – Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës<br>d) Programi 6. Arti dhe Kultura – Ministria e Kulturës<br>e) Programi 7. Shqipëria Dixhitale – Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike<br><br>2.Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit. |
| 1 (një) ditë nga mbyllja e aplikimit | Sekretariati teknik përkatës | Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III. |
| | Sekretariati teknik përkatës | Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar. |
| 1 (një) ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik | Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik) | Vlerësimi i përputhshmërisë me Strategjitë përkatëse kombëtare sipas pikës B, shtojca III. |
| | Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik) | Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve |
| 1 (një) ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati i përgjithshëm | Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR) | Vendimmarrje në lidhje me projektet për tu financuar, nga thirrja e financimit për projekte të inovacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si pjesë e FZHR. |

## SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kritereve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për projektet në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, i ngritur pranë ministrive përkatëse të linjës, sipas aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2015.
2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kritereve të përcaktuara në pikën A, të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.
3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B, të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit.

# Shtojca II
# FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

## Ky format plotësohet për të gjitha projektet

| | |
|---|---|
| Aplikuesi (*) | Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes qendrore ose vendore, autoritetet dhe agjensitë zhvillimore, institucionet e pavarura etj. |
| Data e aplikimit (*) | |
| Titulli i projektit (*) | |
| Programi i projektit (*) | Të përcaktohet cili është programi ku bën pjesë projekti:<br>1. Programi 1: Infrastruktura vendore dhe rajonale<br>2. Programi 2. Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim<br>3. Programi 3. Arsimi dhe Sporti<br>4. Programi 4. Ujësjellës-Kanalizime<br>5. Programi 5. Artin dhe Kulturën<br>6. Programi 6. Shqipëria dixhitale |
| Nënprogrami i projektit (*) | Të përcaktohet nënprogrami i projektit |
| Data e fillimit të projektit (*) | |
| Data e mbarimit të projektit (*) | |
| Përshkrimi i projektit (*) | Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm:<br>- Vendodhja e objektit të investimit;<br>- Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistuese (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt;<br>- Përshkrimi i punimeve/ndërhyrjeve shtesë (sistem ngrohje, mur rrethues etj.) në objektin ekzistues (nëse ka);<br>- Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij;<br>- Rrisqet për zbatimin e tij,<br>- Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj.) |
| | Për projektet e aplikuara nën programin e Axhendës dixhitale:<br>Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm:<br>1. Përshkrimi i gjendjes aktuale;<br>2. Objektivat funksionale dhe ëellimi strategjik;<br>3. Zgjidhja teknologjike;<br>4. Grupet e interesit;<br>5. Logjistika dhe koha ( vlerësimmi i kostos,burimet etj.).<br>6. Komunikimi me sistemet e tjera qeveritare ose lokale. |
| Qëllimi dhe objektivat (*) | Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifikë të tij. |
| Numri i përfituesve (*) | Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi. |
| Rendi prioritar (*) | Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë). |

| | |
|---|---|
| Qëndrueshmëria e projektit (*) | Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt:<br>- Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij;<br>- Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj. |
| Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*) | Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore, apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit. |
| Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore | Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, apo nga donatorë. |
| Financim nga donatorë | Nëse ka financim nga donatorë |
| Financime të tjera | Nëse ka burime të tjera financimi |
| Kostoja totale e projektit (*) | |
| Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale) | Po/Jo |
| Përmbledhje e analizës kosto-përfitim | Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë |
| Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale) | Po/Jo |
| Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis | Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*) | Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe përfundojë procedura e prokurimit publik, si dhe kur mund të fillojë dhe përfundojë zbatimi i punimeve |
| Dokumentat e miratimit të projektit nga njësia e qeverisjes vendore (*) | Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti paraqet:<br>- Vendim të bordit kolegjial drejtues (në rast se është agjenci zhvillimi);<br>- Vendim të këshillit drejtues të njësisë vendore; (komunës/qarkut/bashkisë), për miratimin e sheshit të ndërtimit, dhe ndërtimit të projektit;<br>- Është përfshirë në listën e miratuar nga Këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi);<br>- Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara, nga institucioni përkatës (nëse aplikohet nga institucion qendror)<br>Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkëlidhet një kopje e vendimit/dokumenteve të tjera. |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*) | Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është:<br>- pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës);<br>- pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut;<br>- pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore;<br>- pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'lloj plani);<br>Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti |
| Dokumentet teknike (*) | Të sqarohet nëse projekti përmban:<br>- projektin teknik;<br>- preventivin;<br>- argumentimin teknik;<br>- përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit. |

**(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.**

**SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:**

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:
   - Me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës.
2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës, si dhe listën e projekteve të aplikuara. Projektet e aplikuara duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

**Shtojca III**
**KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE (Shtylla 1 e Financimit: Zhvillimi Vendor dhe Rajonal)**

**A. Kriteret e vlerësimit teknik**

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë** i një projekti.
Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë përkatëse, sipas pikës aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014. Këto kritere konsistojnë në standardet teknike të domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt-zbatimi.
Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.**
2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**
3. Ndikimi i projektit në shërbimet publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillimin ekonomiko-social, në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimin e zhvillimin e aftësive, që vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**, duke plotësuar dy prej komponentëve, si më poshtë vijon:
   a) prek qendër qarkun dhe ndikon në zhvillimin ekonomive vendore, konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin **0 deri 5 pikë.**
   b) ka rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuara biznesi. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**
   c) rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**
   ç) projekti ndikon në rehabilitimin mjedisor dhe krijimim e korridoreve të gjelbër ndërqytetas, si dhe në zona turistike. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

4. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**
5. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i fizibilitetit, analiza kosto - përfitim etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**
6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

7. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

**B. Kriteret e vlerësimit strategjik**

Këto kritere përdoren nga Sekretariati i Përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, **maksimalisht, 30 pikë,** si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qendërqarqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.**
2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëri dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.**

## Shtojca IV
## KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE (Shtylla 2 e Financimit: Shqipëria Dixhitale)

### A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë** i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike (MSHIAP), sipas pikës aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014. Këto kritere konsistojnë në standardet teknike të domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt-zbatimi.

Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe financiar i projekteve të propozuara nga aplikuesit (njësi të e qeverisjes qëndrore, vendore, agjenci zhvillimore etj). Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë(funksionalitete, listë materialesh, bllok-skema etj.), si edhe vlerëson oportunitetin për zbatim të projektit. Vlerëson qëndrueshmërinë e përgjithshme financiare të projektit lidhur me perspektivën e pergjithshme teknike. Një analizë e tregut kryhet nga enti zbatues.
   **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 20 pikë.**
2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit (analizë rrisku) që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**
3. Ndikimi i projektit në zhvillimin ekonomiko-social, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin, përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimin e zhvillimin e aftësive. Niveli i ndikimit të projektit në shërbimet publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, sigurinë dhe shtrirjen gjeografike të shërbimeve, si dhe mbeshtetjen ndaj shërbimeve të tjera që ofrohen nga pushteti qëndror dhe ai vendor.
   **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 20 pikë.**
4. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

5. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i fizibilitetit, analiza kosto - përfitim etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**
6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**
7. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.**

**B. Kriteret e vlerësimit strategjik**

Këto kritere përdoren nga Sekretariati i Përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, **maksimalisht, 30 pikë,** si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë shtetërore (Axhenda dixhitale 2014-2020) dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Vlerësimi për këtë kriter përfshin **nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë**.
2. Shkalla e përputhshmërisë me Programin Operacional dhe drejtimet priortare të "Shqipëria Dixhitale". Vlerësohet nëse projekti paraqet potencial për krijimin e partneriteteve për zhvillim. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.**

**URDHËR**
**Nr. 374, datë 16.1.2015**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 19.1.2015 deri në datën 24.1.2015, zëvendësministrit të Drejtësisë z.Arben Isaraj.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë z.Arben Isaraj për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
**Nasip Naço**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë